

Me gjetë punë

Në krahasim me vendet e tjera në Zvicër ka vetëm pak të papunë. Megjithëkëtë punëkërkuessit duhet të plotësojnë kërkesa të larta. Dëftesat dhe diplomat kanë domethënie të madhe. Njohuria e gjuhës gjermane është një parakusht pothuajse për çdo vend të punës.

Kualifikimet

Profesionet e përfunduara, diplomat dhe kualifikimet e mëtejshme kanë në Zvicër gati në të gjitha profesionet vlerë të lartë. Diplomat e huaja nuk pranohen çdoherë. Shumë të rëndësishme gjatë kërkimit të një pune janë edhe dëftesat e punës të punëdhënësit të mëhershëm. Për shumicën e vendeve të punës janë njohurit e gjuhës gjermane të nevojshme.

Me gjetë një vend pune

Ofertat e vendeve të punës i gjen njeriu në gazeta ditore edhe në portale të ndryshme të internetit. Tutje ka zyra private ndërmjetësuese për punë. Qendrat publike rajonale për ndërmjetësim në punë (RAV) mundën me ndihmë gjatë kërkimit të një vendi të punës. Aty ka kompjuter dhe gazeta ditore në dispozicion dhe punonjësit i këshillojnë punëkërkuessit.

Aplikimi

Për një vend pune aplikon njeriu normalisht me shkrim, me email ose online. Për një aplikim duhet më së paku një biografi, një shkresë për motivim dhe nëse është e mundshme një kopje nga dëftesat përfundimtare, diplomat dhe dëftesat e punës. Nëse punëdhënësi është i interesuar, njeriu do të ftohet për një bisedë prezantimi personal (Vorstellungsgespräch). Vende të ndryshme ofrojnë mbështetje falas për përgatitjen e shkresës për aplikim.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/puna/me-gjete-pune